



Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 11, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimit, 01-Nr-105, të datës 26.05.2003, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 30.04.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit

Neni 1

Emërohet komisioni për pranimin dhe nominimin e propozimeve që vijën nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave për dhënien e shpërblimeve "Emblema e artë", "Skënderbeu" dhe mirënjohjes "13 Qershori" me këtë përbërje:

- 1.1. Bexhet KUÇI-----kryesues
- 1.2. Ilir VOÇI-----anëtar
- 1.3. Labinot HALITJAHA-----anëtar
- 1.4. Antigona ZYBA-----anëtare
- 1.5. Mimoza BAJRAKTARI-----anëtare
- 1.6. Sejdi ELEZI-----anëtar
- 1.7. Adem BYTYÇI-----anëtar

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga qytetarët, institucionet, shoqatat, kryesitë e fshatrave, prej individëve, etj, bazuar në vendimet e Kuvendit të Komunës për ndarjen e shpërblimit "Emblema e artë", shpërblimit "Skënderbeu" dhe mirënjohjes, "13 Qershori" të datës 26.05.2003 dhe pas kryerjes së detyrës propozimet i dorëzojnë tek Kuvendi i Komunës për miratim.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-19544
Më datë 30.04.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI